



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P- 106
Prishtinë, më 29 prill 2010

P R O C E S \ V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 29 PRILL 2010**

Seancën e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetari i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 94 deputetë.

Në fillim të seancës, për fjalë u paraqitën këta deputetë.

Deputeti **Gani Geci** bëri vërejtje në protokollin shtetëror lidhur me fillimin e punimeve në autostradën Vërmicë – Merdare, për prezencën dhe mënyrën e radhitjes së ulëseve për pjesëmarrësit në këtë ceremoni.

Deputeti **Naim Rrustemi** ngriti çështjen e komentimit të diskutimeve të deputetëve nga ana e kryesuesit të seancës plenare, për të cilën, shtoi ai, se duhet të respektohet Rregullorja e Kuvendit.

Deputeti **Riza Smaka** ngriti çështjen e pagave të ulëta të pensionistëve të Kosovës. Ai kërkoi që në mënyrë urgjente të procedohet në Kuvend Ligji për sigurimet pensionale dhe invalide.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ai i njoftoi deputetët se në ndërkohë, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me shefat e grupeve parlamentare, ka vendosur që rendi i ditës të plotësohet me dy pika shtesë, dhe atë:

- Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin Kosovar të Konkurrencës dhe
- Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Kuvendi, me propozimin e kryetarit, miratoi pikat shtesë të rendit të ditës.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Propozim- Rregullores së Kuvendit,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pagat e nëpunësve civilë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mjekësinë ligjore,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për konfliktet administrative,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për metrologji,
11. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2009,
12. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2009,
13. Shqyrtimi i Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2009,
14. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, për vitin 2009,
15. Shqyrtimi i Raportit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2009,
16. Shqyrtimi i Propozim - vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të pavarur për rishqyrtimin e ankesave,
17. Shqyrtimi i Propozimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
18. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për rritjen e numrit të oficerëve korrektues në Burgun e Dubravës,
19. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për rritjen e numrit të nëpunësve në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar,
20. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, për lejimin e afatit shtesë për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, dhe
21. Propozimi i Grupit Parlamentar i LDD-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

22. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin Kosovar të Konkurrencës dhe
23. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 15 prill 2010

Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 15 prill 2010, u miratua pa vërejtje. Deputeti Driton Tali pati vërejtje në transkript, që është korrigjuar sipas kërkesës së tij.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Driton Tali parashtoi pyetje për ministrin Ahmet Shala, lidhur me garancionin bankar prej 16.2 mil.€ të Operatorit të telefonisë së dytë mobile në Kosovë.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja Synavere Rysha parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi, lidhur me pronat e ndërmarrjeve shoqërore të Kosovës, në ish- republikat jugosllave, kryesisht në Serbi dhe Mal të Zi.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Rysha.

Deputeti Naim Rrustemi parashtoi pyetje për ministren Justina – Pula- Shiroka , lidhur me energjinë elektrike që KEK-u ka importuar nga kompania “GEN” e Beogradit e cila është e palicencuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Ministrja Justina- Pula- Shiroka iu përgjigj pyetjes së deputetit Rrustemi.

Deputeti Nait Hasani parashtoi pyetje për ministrin, Nenad Rashiq, lidhur me ndërprerjen e sigurimeve të punëtorëve tanë në Zvicër dhe hapat që ka ndërmarrë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në këtë drejtim.

Ministri Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetit Hasani.

Deputeti Driton Tali parashtoi pyetje për ministren, Justina - Pula- Shiroka lidhur me çështjen e futjes së “Kosovës B” në pakon e” Kosovës së Re,” se me cilët këshilltarë të transaksioneve dhe miq ndërkombëtar është këshilluar ajo?

Kryeministri Hashim Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja Gjylnaze Syla parashtoi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbardhjen e rastit të vjedhjes në Dhomën e Dëshmive në Policinë e Kosovës, para një viti.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputeti Riza Smaka parashtoi pyetje për ministrin, Ahmet Shala lidhur me aktivitetet bankare dhe rrjedhat e pavolitshme për investimet dhe depozitimet legale në tregun bankar, tek ne.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti Riza Smaka parashtroi pyetje për ministrin, Mahir Yagcilar, lidhur me mbrojtjen e shtretërve të lumenjve në vendin tonë

Ministri Yagcilar iu përgjigj pyetjes se deputetit Smaka.

Deputetja Suzan Novoberdaliu parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me deklaratën e shefit të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, Renzo Davidi, për shkallën e korrupsionit në Kosovë.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes se deputetes Novoberdaliu.

Deputeti **Arsim Rexhepi** e tërhoqi pyetjen për ministrin **Bajram Rexhepi**.

Deputeti **Riza Smaka** ka marrë përgjigje me shkrim në pyetjen e parashtruar, po ashtu me shkrim, për ministrin **Sadri Ferati**, lidhur me adresat e vendbanimeve dhe emërtimet e toponimeve, në përgjithësi. Pyetja nr. 03/3428/Do-2155, e datës 30.03.2010.

3. Shqyrtimi i dytë i Propozim - Rregullores së Kuvendit

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, që ta arsyetojë propozim-amendamentet e Rregullores.

Kryetari i Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, **Hydajet Hyseni** tha se Komisioni paraqet për shqyrtim të dytë dhe miratim Rregulloren e re të Kuvendit, me ndryshime dhe plotësime të propozuara, të përfshira në Raportin e Komisionit të 10 marsit 2010, si dhe plotësimin e raportit të 22 prillit të këtij viti.

Një rregullore tërësisht e re, mbetet synim për një të ardhme, besoj jo shumë të largët. Në këtë fazë Komisioni ka synuar dhe mendoj se ka arritur të realizojë harmonizimin e Rregullores me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, harmonizimin me referencat e saj në dokumentin e zotit Ahtisari.

Rregullorja e re mundëson funksionalizimin më të mirë dhe më efektiv të Kuvendit, përmirësimin e funksionit të pavarur të ndërlidhur, transparent, të balancuar dhe llogaridhënës ndërmjet pushteteve, raportin adekuat dhe përplotësues pozitiv – opozitiv, shumicë – pakicë, përshtatjen dhe saktësimin e afateve në procesin ligjvënies, si dhe inkorporimin në Rregullore të rekomandimeve nga Raporti i progresit.

Ndryshimet e bëra do të lehtësojnë jo vetëm procesin e tranzicionit institucional, por edhe funksionimin më të mirë parlamentar dhe ndërinstitutional.

Ai paraqiti edhe qëndrimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, i cili mbështet amendamentet e propozuara.

Kryetari shpjegoi se, në bazë të nenit 76 të Kushtetutës, për miratimin e Rregullores së Kuvendit, duhen të votojnë 2/3 e deputetëve të Kuvendit.

Më pas, kryetari procedoi me votimin e amendamenteve, një nga një.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32,33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41,

42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54 dhe 55, si dhe amendamentet plotësuese të Komisionit 1 dhe 2.

Në fund, kryetari hodhi në votim tekstin e Projekt-Rregullores me amendamente e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----90,
Kundër----- Asnjë.
Abstenime----- Asnjë.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, njëzëri miratoi Rregulloren e Kuvendit.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Komisionit FunkSIONAL që ta arsyetojë raportin para deputetëve të Kuvendit.

Deputetja Melihate Tërmkolli, në emër të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, tha se Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për Shërbimin Civil, ka bërë një punë po thuaj se që nga fillimi dhe krejt kjo si pasojë e asaj që është kërkuar ligji t'i kthehet Qeverisë për t'u ripunuar, por kjo nuk ka ndodhur.

Nga 105 nene, sa i ka projektligji, janë punuar 203 amendamente. Grupi punues dhe Komisioni kanë bërë një punë grandioze duke pasur parasysh se është fjala për një ligj shumë të rëndësishëm, pra kanë bërë një punë me përgjegjësi të plotë.

Amendamentet e punuara lidhen me çështjet esenciale, me çështje substanciale të funksionimit të Shërbimit Civil, për një shërbim civil të reformuar, të depolitizuar dhe profesional, duke evituar kështu tendencën e Qeverisë për një shërbim civil jo profesional dhe të politizuar.

Amendamentet janë punuar për 3 muaj, në bashkëpunim të plotë edhe me ekspertët vendor dhe ndërkombëtar, në kuptim të harmonizimit dhe përafrimit me standardet evropiane. Kemi punuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me ekspertët, me DFID-in, SIGMA-n, ICO, Bankën Botërore e të tjerë, sugjerimet e të cilëve Qeveria e Kosovës nuk i ka përfillur dhe duke i shpërfillur këto, na ka nxjerrë edhe një punë shtesë dhe po shihet shumë mirë se edhe me shpërfilljen nga Fondi Monetar, çfarë po ndodhë me vendin tonë.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni tha se kanë shqyrtuar me vëmendje amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për të cilat kanë disa vërejtje në amendamentet e propozuara.

Së pari, janë 110 dispozita të reja, ndërsa krejt ligji i ka pasur 100 nene. Janë 50 dispozita të cilat janë fshirë nga ligji ekzistues, nga projektligji.

Në amendamentin 49, në raportin përfundimtar kanë lëvizur për dy amendamente. Thotë, neni 14.4 fshihet dhe riformulohet: “Anëtarë të Komisionit”, është fjala për emërimet publike, “nuk do të jenë ministri, deputeti i Kuvendit, shërbyesit civilë ose këshilltari politik në një institucion shtetëror”. Ne po e shtrojmë dilemën, nëse nuk janë këto katër kategori, kush do të jenë?

Amendamenti 50, bie tash ndesh komplet edhe me Kushtetutën. Mandej, amendamenti tjetër 51, thotë: Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me kryeministrin, me anëtarët e Kryesisë së Kuvendit e zgjedh kryesuesin e një komisioni. Unë po e shtroj këtë çështje. Ku janë kompetencat e Kryesisë së Kuvendit të vendosë për shërbimin civil dhe për çka po konsultohet organi më i lartë – Kuvendi, me presidentin, me Kryesinë për ta bërë një kryesues të një komisioni që ka të bëjë me intervistat e zyrtarëve publik...? S'po ndalem, ka edhe shumë amendamente tjera. Komisioni, në mënyrë unanime, ka dhënë një rekomandim që të ulemi dhe t'i harmonizojmë amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional.

Kryetari hapi debatin lidhur me amendamentet e propozuara në Projektligjin për shërbimin civil.

Opinione dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të LLD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar "7 Plus", Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Petar Miletiq dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Numan Baliq, si dhe deputetët Esat Brajshori, Jakup Krasniqi, Naim Rrustemi, Hajredin Hyseni dhe Gani Koci, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kuvendi mori këtë

V E N D I M

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Projektligji për pagat e nëpunësve civilë shtyhen për seancën e radhës, më 13 maj 2010.
2. Ngarkohen Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal e Media dhe Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, që t'i harmonizojnë rekomandimet, përkatësisht amendament e kontestuar në Projektligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.
3. Raporti me rekomandime t'i dorëzohet Zyrës për Parashpresa të Administratës së Kuvendit deri më 10 maj 2010.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mjekësinë ligjore

Në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni e arsyetoi Raportin dhe amendamentet e propozuara.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, Kryesuesi i hodhi në votim një nga një, amendamentet e Komisionit funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12.

Kryesuesi në vazhdim hodhi në votim tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----70,
Kundër-----Asnjë,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për mjekësi ligjore.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale

Në emër të Komisionit funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri, **Rrustem Mustafa** e arsyetoi Raportin dhe amendamentet e propozuara.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, Kryesuesi i hodhi në votim një nga një, amendamentet e Komisionit funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82 dhe 83.

Kryesuesi në vazhdim hodhi në votim tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----72,
Kundër-----Asnjë,
Abstenime-----3.

Kryesuesi, konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme

Kryesuesi ftoi ministrin e Ekonomisë dhe Financave, që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Ahmet Shala në fillim tha se në kuadër të strategjisë legjislative, Ministria për Ekonomi dhe Financa ka hartuar Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme, me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë dhe janë ofruar praktikat më të mira të legjislacionit evropian. Kjo fushë deri më tani është e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut, 2003/29, kurse nisma për hartimin e këtij projektligji ka të bëjë edhe me ndryshimet e përgjithshme ekonomike dhe progresive në Kosovë, tha ministri.

Në vazhdim tha se ky projektligj përcakton subjektet që i nënshtrohen pagesës së tatimit në pronën e paluajtshme dhe që nuk i nënshtrohen këtij tatimi, pastaj shkallën e tatimit etj.

Më tej ai potencoi se ky projektligj përcakton dhe ngrit përgjegjësitë e komunave për menaxhimin e pronës, në vlerësimin e saj, në vjeljen e tatimin në pronën e paluajtshme, përcakton procedurat e ankesës, mënyrat e shpërndarjes së faturave tatimore, masat sanksionuese etj.

Ministri tha se projektligji ka 46 nene dhe është në harmoni me legjislacionin e BE-së, kurse në fund i ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletqi, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputeti Naser Rugova, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----53,

Kundër-----Asnjë ,

Abstenime-----6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për konfliktet administrative

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për konfliktet administrative.

Ministrja e Administratës Publike, **Edita Tahiri** tha se Projektligji për konfliktet administrative ka për qëllim që të rregullojë konfliktin administrativ, mbrojtjen gjyqësore të drejtave të personave fizikë dhe juridikë, si dhe vlerësimin e ligjshmërisë së akteve administrative në procedurën administrative.

Me këtë projektligj rregullohen në tërësi marrëdhëniet në kontestet administrative ndërmjet organeve të administratës, palëve dhe gjykatave kompetente.

Projektligji përmban 64 nene. Pjesa e parë, përkatësisht dispozitat themelore, ku bëjnë pjesë nenet 1,2,3,4,5 dhe 6, përfshin përkufizimet e termave për nevojat e këtij ligji.

Neni 7 deri në nenin 16 të këtij ligji, parasheh mundësinë e fillimit të konfliktit administrativ kundër aktit administrativ, kundër të cilit nuk ka mjete të rregullta juridike në procedurën administrative, si dhe aktet administrative kundër të cilave nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ. Nenet 17, 18 dhe 19 të këtij ligji përcaktojnë kompetencën për vendosje në konfliktin administrativ, përbërjen e kolegjit, rastet kur dhe nga kush paraqiten mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Prej nenit 20 deri në nenin 41 të këtij ligji është paraparë procedura në bazë të padisë, me të cilën rregullohet mënyra e fillimit, vazhdimit dhe përfundimit të konfliktit administrativ.

Procedura sipas mjeteve juridike është paraparë nga neni 44 deri në nenin 55. Në pjesën - Dispozita të tjera të procedurës, është paraparë që nëse ky ligj nuk përmban rregulla për konfliktin administrativ, atëherë do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore, si dhe bartja e shpenzimeve.

Nenet 58, 59, 60 dhe 61 përcaktojnë karakterin e detyrueshëm të aktgjykimit dhe rregullat se si të veprohet pas anulimit të aktit administrativ.

Në dispozitat e fundit dhe kalimtare është paraparë që për paditë e paraqitura deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji të aplikohen dispozitat e ligjit të aplikueshëm, si dhe shfuqizimi i të gjitha dispozitave të ligjit të aplikueshëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Për zbatimin e këtij ligji nuk nevojitet të nxirren akte nënligjore, si dhe nuk do të ketë implikime buxhetore.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për konfliktet administrative.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hajredin Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletij dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Numan Baliq, si dhe deputetët Arsim Bajrami, Nekibe Kelmendi, Nerxhivane Dauti dhe Sanije Aliaj, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----60,
Kundër-----Asnjë ,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për konfliktet administrative.

Kuvendi i ngarkon këto komisione: Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për metrologji

Kryesuesi ftoi ministrin e Tregtisë dhe Industrisë që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Ministri Lutfi Zharku tha se në këtë fushë deri më tani janë vërejtur disa vështirësi, të cilat jemi munduar t'i eliminojmë përmes këtij projektligji, si parakusht për zbatimin e standardeve të BE-së.

Gjatë hartimit të këtij projektligji jemi bazuar në dokumentet ndërkombëtare për metrologji, pastaj në Raportin e progresit të BE-së për Kosovën për vitin 2009 etj, tha ministri.

Në vazhdim tha se ky projektligj mundëson forcimin e pozicionit të metrologjisë, kompetencat për instancat e caktuara, procedurat për mbikëqyrje metrologjike etj.

Ministri në fund i ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për metrologji.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për metrologji.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nerxhivane Dauti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar "7+" Sadik Idriz, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Riza Smaka, Bujar Dugolli dhe Lutfi Zharku, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----69,

Kundër-----0,

Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin për metrologji.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropiane, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryesuesi, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, mbylli punimet e seancës së sotme në orën 17:50, për t'i vazhduar më 30 prill 2010.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në ora 17:12 minuta.

E premte, 30 prill 2010, në orën 10,
Vazhdimi i seancës plenare

Seancën e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetari i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kuvendi i vazhdoi punime me shqyrtimin e 11 të rendit të ditës.

11. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2009

Kryetari ftoi kryetarin e Komisionit parlamentar për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media që ta marr fjalën.

Deputeti Esat Brajshori tha se komisioni që ai e udhëheq ka shqyrtuar Raportin e KPM-së dhe për çështjet e paraqitura në atë Raport, ne si komision nuk kemi gjetur ndonjë mangësi.

Në vazhdim tha se KPM-ja ka bërë punë të madhe, por fushëveprimi i saj kërkon harmonizim edhe me organet tjera. Ai më tutje përmendi Konferencën rajonale të organizuar nga KPM, kohë më parë, si dhe përpjekjet që KPM-ja ka bërë, në bashkëpunim me OSBE-në, për licencimin e mediave elektronike të cilat veprojnë në veri të Kosovës, por që deri më tani nuk kanë rezultuar me sukses.

Një grup punues po punon për hapjen e kanalit të dytë të RTK-së, i cili do t'u dedikohet minoriteteve në Kosovë, tha deputeti Brajshori.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hajredin Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Esat Brajshori, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar "7+" Shpresa Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletqi, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Danush Ademi, si dhe deputetët: Abdyl Ymeri, Numan Baliq dhe Naser Rugova që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij Raporti.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----60,

Kundër-----Asnjë ,

Abstenime-----6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin e Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2009

12. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2009

Deputetja Safete Hadergjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, paraqiti arsyetimin e Raportit të Komisionit funksional.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së,

Lulzim Zeneli, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Bahri Hyseni, Driton Tali, Naim Rustemi, Arsim Bajrami, Myrvete Pantina, Naser Rugova, Berim Ramosaj, Branislav Grbiç, Besa Gaxherri, Qamile Morina dhe Gani Koci, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij raporti. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----52,
Kundër-----2,
Abstenime-----9.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2009.

13. Shqyrtimi i Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2009

Gani Koci, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, paraqiti për këtë pikë të rendit të ditës, arsyetimin e Raportit të Komisionit funksional.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Suzan Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Abdyl Ymeri, Kaqusha Jashari, Naim Rustemi, Driton Tali dhe Myrvete Pantina, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij raporti. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----49,
Kundër-----3,
Abstenime-----9.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2009.

14. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, për vitin 2009

Bahri Hyseni, në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, paraqiti për këtë pikë të rendit të ditës, arsyetimin e Raportit të Komisionit funksional.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-

së, Selville Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletqi, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Bajram Kosumi, Gani Geci, Ibrahim Gashi, Sanije Aliaj, Rita Hajzeraj, Driton Tali, Ramadan Avdiu, Naim Rrustemi, Naim Maloku, Nekibe Kelmendi, Suzan Novoberdaliu dhe Sabri Hamiti, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij raporti. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----58,
Kundër-----0,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi Raportin e Agjencisë kundër Korrupsionit për vitin 2009.

Kryesuesi, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, mbylli punimet e seancës së sotme në orën 17:50, për t'i vazhduar të martën, më 4 maj 2010.

.

E marte, 4 maj 2010, në orën 10, Vazhdimi i seancës plenare

Seancën e drejtoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 63 deputetë. Kuvendi i vazhdoi punimet me pikën 15 të rendit të ditës.

15. Shqyrtimi i Raportit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2009

Deputetja Safete Hadergjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, paraqiti arsyetimin e Raportit të Komisionit funksional.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletqi, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Abdyl Ymeri, Mimoza Ahmetaj, Driton Tali, Teuta Hadri, Fatmir Rexhepi, Myzejene Selmani, Kaqusha Jashari, Berim Ramosaj,

Gani Buçinca, Drita Kadriu, Ibrahim Gashi, Ramadan Avdiu dhe Synavere Rysha, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij Raporti.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----15,
Kundër-----49,
Abstenime-----12.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Kuvendi nuk miratoi Raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2009.

16. Shqyrtimi i Propozim - vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave

Deputetja Safete Hadergjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, paraqiti arsyetimin e Raportit të Komisionit funksional, i cili nuk e ka përkrahur listën e kandidatëve të propozuar nga Qeveria.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Propozim - vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim - vendim dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Xhezair Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Numan Baliç, si dhe deputetët: Riza Smaka dhe Eqrem Kryeziu, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij propozim-vendimi.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----20,
Kundër-----38,
Abstenime-----10.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Kuvendi nuk miratoi propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave.

17. Shqyrtimi i Propozimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Bahri Hyseni, në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, paraqiti për këtë pikë të rendit të ditës arsyetimin e Raportit të Komisionit funksional.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Propozimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Xhezair Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetja, Nekibe Kelmendi, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij Propozimi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----45,
Kundër-----18,
Abstenime-----6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

I. Anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës emërohen:

1. Fejzullah Hasani - Gjykata Supreme e Kosovës,
2. Miodrag Paviq - Gjykata Supreme e Kosovës,
3. Osman Ismaili - Fakulteti Juridik,
4. Vesel Jashari - Prokuroria e Shtetit të Kosovës,
5. Radica Miliq - Shoqata e Prokurorëve Publik të Kosovës,
6. Destan Rukiqi - Oda e Avokatëve të Kosovës,
7. Elmaze Syka - Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës,
8. Rexhep Murati – Lidhja e Juristëve të Kosovës.

II. Mandati i të emëruarve nga pika **I.** e këtij vendimi zgjat dy (2) vjet.

18. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për rritjen e numrit të oficerëve korrektues në Burgun e Dubravës

Ministri **Haki Demolli**, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, arsyetoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për rritjen e numrit të oficerëve korrektues në Burgun e Dubravës. Ai saktësoi se nuk është fjala për rritje të numrit të punëtorëve në këtë burg , por bëhet fjalë për të punësuar të rinj në pavijonin e saponjëtarëve për dëshmitarë të dënuar të mbrojtur, në kuadër të këtij burgu.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Propozim - vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për punësimin e oficerëve korrektues në Burgun e Dubravës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim - vendim dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Nekibe Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Rita Hajzeraj-Beqaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Numan Baliq, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij propozim-vendimi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----61,
Kundër-----1,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Për punësimin e oficerëve korrektues në Burgun e Dubravës për dëshmitarë të dënuar të mbrojtur

1. Miratohet Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për punësimin e numrit të oficerëve korrektues për shtatëdhjetë e një (71) pozita në Burgun e Dubravës, për dëshmitarë të dënuar të mbrojtur.
2. Shpenzimet buxhetore deri në rishikim të buxhetit të mbulohen nga burimet e brendshme të Ministrisë së Drejtësisë, dhe në procesin e rishikimit të buxhetit për vitin 2010, Qeveria të sigurojë mjete të rregullta financiare për mbulimin e këtyre shpenzimeve, duke mos kaluar kufijtë e përgjithshëm të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010.

19. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për rritjen e numrit të nëpunësve në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar

Ministri **Haki Demolli**, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, arsyetoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për rritjen e numrit të nëpunësve në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar.

Ai saktësoi se bëhet fjalë për themelimin e një agjencie të re për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar, e cila sipas ligjit është dashur të bëhet nga 1 janari 2010. Ministri Demolli kërkoi nga Kuvendi miratimin e këtij propozim-vendimi.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Propozim - vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për punësimin e nëpunësve në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim - vendim dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Nekibe Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij Propozim-vendimi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----65,
Kundër-----3,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Për punësimin e një numri të punonjësve në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar

1. Miratohet Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për punësimin e numrit të punonjësve për shtatëmbëdhjetë (17) pozita në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar.
2. Shpenzimet buxhetore deri në rishikim të buxhetit të mbulohen nga burimet e brendshme të Ministrisë së Drejtësisë, dhe në procesin e rishikimit të buxhetit për vitin 2010, Qeveria të sigurojë mjete të rregullta financiare për mbulimin e këtyre shpenzimeve, duke mos kaluar kufijtë e përgjithshëm të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010.

20. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për lejimin e afatit shtesë për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje

Ismet Beqiri, në emër të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, e arsyetoi kërkesën.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi kërkoi nga Kuvendi që nëpërmjet një votimi formal, me ngritje dore, deputetët të deklarohen për kërkesën e Komisionit funksional.

Kuvendi miratoi kërkesën e Komisionit funksional.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Komisionit për Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, i lejohet afati shtesë prej 15 ditëve për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.

21. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDD-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi kërkoi nga Kuvendi që nëpërmjet një votimi formal me ngritje dore, deputetët të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar i LDD-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet Parlamentare.

Kuvendi miratoi propozimin e Grupit Parlamentar i LDD-së që deputeti Gani Geci, të emërohet anëtar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, në vend të deputetit Adem Salihaj dhe deputetja Drita Maliqi, emërohet anëtare në Komisionin për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, në vend të deputetit, Adem Salihaj.

22. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Myzejane Selmani, në emër të Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, e arsyetoi raportin e këtij komisioni.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Propozim - vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim - vendim dha deputeti Shkumbin Demaliaj. që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi. Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij Propozim-vendimi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----46,
Kundër-----14,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

Për emërimin e anëtarit në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

1. Naser Osmani, emërohet anëtar në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
2. Mandati i të emëruarit, nga pika 1. e këtij vendimi zgjat dy (2) vjet.

23. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin Kosovar të Konkurrencës

Kryesuesi, pasi i njoftoi deputetët me Propozim – vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin Kosovar të Konkurrencës, e hodhi atë në votim. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----46,
Kundër-----11,

Abstenime-----7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Për emërimin e anëtarit në Komisionin Kosovar të Konkurrencës

1. Gani Asllani, emërohet anëtar në Komisionin Kosovar të Konkurrencës.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat pesë (5) vjet.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 13:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale